



Pranuar / Dorezuar Punëhena/Prodato Received/Delivery	28.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHUK	6524/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A .nr.796/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Jeton Kocanëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.796/2022 e datës 13.09.2022, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi:

nga Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.796/2022, të datës 13.09.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër protokolli 1194 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit i datës 07.09.2022.
- III. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, që ta emërojë ankuesin me Akt Emërim në pozitën "Zyrtar për Arkiv 3" sipas legjislacionit në fuqi.
- IV. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Obiliqit, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsyetim

Komuna e Obiliqit, sipas njoftimit të datës 09.12.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin "Specialist të Arkivit-Dokumentacionit" për pozitën "Zyrtar për Arkiv 3", me numër referencë RN00007958 për afatin e aplikimit nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 07.09.2022 ka nxjerrë vendimin me numër protokollit 1194, përmes të cilit e ka bërë anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Arkiv 3" për të cilën pozitë ankuesi ishte shpallur kandidatë fitues.

Ankuesi me datë 13.09.2022, me numër të protokollit 5346/2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Kryetari i Komunës së Obiliqit me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 07.09.2022 me numër protokollit:1194, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material sikurse edhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit për diskriminim, me kërkesën të anulohet vendimi i goditur me ankesë ndërsa ankuesi të emërohet me akt emërimin në pozitën për të cilën është shpallur kandidat fitues nga ana e Komisionit të Pranimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 19.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datë 06.10.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:** Ankesa A.nr. 796/2022 e të datës 13.09.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.09.2022, me numër protokollit 1194, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Raporti përfundimtar i datës 29.04.2022, me numër protokollit 156; Konkurs i datës 09.12.2021;Vendimi i datës 22.07.2022, A. Nr. 515/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.07.2022, A. Nr. 502/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Lista e Apikanteve; Vendimi i datës 14.03.2022, me numër protokollit 11-235, për themelimin e Komisionit të Pranimit; e- maili i datës 24.06.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë datës 06.09.2012; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë datës 01.07.2015; Vërtetim i datës 04.08.2021; Diplomë e datës 19.09.2018; Vërtetim i muajit shtator; Referencë e datës 03.08.2021; Aplikacionin i me shkresat e bashkangjitur; Diplomë e datës 23.06.2012; Diplomë e datës 03.12.2016; Certifikatë e datës 01.06.2012; Vendimi i datës 07.09.2022, me numër protokollit 1194, i Kryetari i Komunës së Obiliqit; Përgjigje në ankesës e datës 06.10.2022, me numër 5923/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar,  
**SEPSE:**



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi për pozitën e punës "Zyrtar për Arkiv 3" të shpallur nga Komuna e Obiliqit, sipas formularit të renditjes përfundimtare të datës 29.04.2022 ka arritur gjithsejtë 76.8 pikë, respektivisht është renditur i pari nga të gjitha kandidatët pjesëmarrës, ndërsa të pakënaqur më vlerësimin përfundimtar dy kandidatët e tjerë në të njëjtën procedurë dhe për të njëjtën pozitë, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes Vendimit të datës 20.07.2022 me numër A.nr.502/2022 e kishte refuzuar ankesën e ankuesit [ ] cili kishte grumbulluar gjithsejtë 71.2 pikë dhe ishte renditur kandidati i treti, dhe po ashtu Këshilli përmes Vendimit të datës 21.07.2022 me numër A.nr.515/2022 e kishte refuzuar ankesën e ankueses [ ] e cili kishte grumbulluar gjithsejtë 73.4 pikë dhe ishte renditur kandidatja e dytë sipas formularit të renditjes përfundimtare të datës 29.04.2022.

Kryetari i Kryetari i Komunës së Obiliqit, me datë 07.09.2022, ka nxjerr vendimin me numër protokollit 1194 përmes të cilit e ka anuluar procedurën e rekrutimit me numër RN00007958, për pozitën "Zyrtar për Arkivë 3" në të cilën procedurë sipas formularit të renditjes përfundimtare të nxjerrë nga Komisioni i Pranimit më datë 29.04.2022, ankuesi ishte renditur si kandidati me më së shumti pikë në kuadër të kandidatëve të suksesshëm. Kryetari i Komunës së Obiliqit, anulimin e konkursit e ka arsyetuar me supozimin se procedura e rekrutimit ka zgjatur shumë, dhe se pas vendosjes nga ana e ekzekutivit të komunës për organizmin e punëve nëpër drejtori, për shkak të rëndësisë së pozitës, pozita e lartcekur është plotësuar me nëpunës brenda institucionit, respektivisht me dy nëpunës [ ] me vendimin Nr. II 377, të datës 21.04.2022, si dhe Sala Paci me vendim Nr.II/369 të datës 21.04.2022.

Pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit, Komisioni për vlerësim i Komunës së Obiliqit, ka bërë renditje përfundimtarë me të cilin, kandidatin [ ] e ka vlerësuar me gjithsejtë shtatëdhjetë e gjashtë pikë tetë (76.8) dhe nga shkresat e lëndës del se ankuesi i ka plotësuar kushtet për zgjedhur në pozitën e lartcekur dhe së kjo çështje juridike është vërtetuar përmes vendimeve A. Nr. 515/2022, i datës 22.07.2022, se ankueses [ ] si dhe për mes vendimit A. Nr. 502/2022, i datës 22.07.2022, së ankuesit [ ] të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërlidhur me rekomandim e Komisioni për pranim të Komunës së Obiliqit, me të cilin rekomandim është rekomanduar si kandidat i suksesshëm [ ] për pozitën / Zyrtar për Arkivë 3", në Komunën e Obiliqit, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së Komisionit për Pranimi i Komunës së Obiliqit, ka vepruar në pajtim me nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet: "1.Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës së konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregullore".





Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se akti i ankimuar në Këshill përmes ankesës së datës 13.09.2022, respektivisht Vendimi me numër protokolli 1194 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit i datës 07.09.2022 është i kundërligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”* ngase dispozitat e ligjit material nuk përcaktojnë afatin e saktë kohor se sa do të zgjas një procedurë rekrutimi, ngase në secilën fazë të saj Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka paraparë dhe njohur të drejtën e ankimit të brendshëm sikurse edhe ankesën në Këshill, rrjedhimisht për procedurën në fjalë në Këshill kanë qenë të parashtruara dy ankesa dhe sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”*, këto të dy ankesa, gjegjësisht ankesa e datës 08.06.2022 dhe ankesa e datës 06.06.2022 kanë pasur efekt pezulluar rrjedhimisht e kanë zgjatur zhvillimin dhe përfundimin e procedurës në fjalë, deri në zgjidhjen e tyre meritore nga ana e Këshillit përmes Vendimeve A.nr.515/2022 dhe A.nr.502/2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Vendimi me numër protokolli 1194 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit i datës 07.09.2022 është i kundërligjshëm edhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”*, ngase i njëjti nuk i përmbush kriteret e caktuara ligjore në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i të njëjti ligj, pasi që arsyetimi dhënë me rastin e anulimit të procedurës së rekrutimit në të cilën procedurë ankuesi është kandidati më i vlerësuar, respektivisht arsyetimi i dhënë është i pa mjaftueshëm dhe barabartë me mungesën e tij, ngase i njëjti nuk ka arritur të përmbush kriterin ligjor të përcaktuar me nenin 48 paragrafi 1 në paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe se arsyetimi dhënë për anulimin e konkursit për shkak të zgjatjes së procedurës është i paqëndrueshëm dhe pa bazë ligjore, andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit i datës 07.09.2022 me numër protokolli 1194 është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, konstaton se Komuna e Obiliqit, pas pranimit të vendimit të Këshillit, është e obliguar që të veprojë në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet: *“1.Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitat e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidateve fitues”*, prandaj Kolegji i Këshillit, konstaton se Komuna e Obiliqit, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore, është e obliguar që veprojë në pajtim me rekomandim e Komisioni për Pranim të Komunës së Obiliqit i datës 29.04.2022, sipas të





cilit rekomandim apo akt përfundimtar të procedurës së rekrutimit është konstatuar se ankuesi sipas pikëve të grumbulluara e ka të drejtën për emërim në pozitën "Zyrtar për Arkivë 3", pasi që është kandidati me më shumë pikë në kuadër të listës së kandidatëve të suksesshëm.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se, organi i punësimi Komuna e Obiliqit, është e obliguar që pas pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet sipas diapozitivit të vendimit të Këshillit, dhe të veprojë në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.769/2022**

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komuna e Obiliqit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.